



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2059/1 Prot

Rrëshen më, 23 . 06 . 2025

V E N D I M

Nr. 49 datë 19. 06. 2025

P Ë R

**“MIRATIMIN E ZGJERIMIT TË SIPËRFAQES SË VARREZAVE, NË FSHATRAT RRETHI I EPËRM, KATUNDI VJETËR, NJËSIA ADMINISTRATIVE RUBIK, 4603 DHE NË FSHATIN SHPAL, NJËSIA ADMINISTRATIVE OROSH, 4605”,
BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” *të ndryshuar*, neni 6, gërma “i”, të VKM nr. 408, datë 13. 05. 2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” *të ndryshuar* me VKM nr. 686, datë 22. 11. 2017, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen e pronave private për interes publik” *i ndryshuar*, projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë; (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), *pas shqyrtimit dhe miratimit, në mbledhjen e datës 17. 06. 2025, të Komisionit të Shërbimeve Publike, Transportit dhe Infrastrukturës*, për t’ia kaluar në seancë Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

Duke marrë në konsideratë:

- Kërkesën e banorëve të fshatrave përkatës (Rrethi i Epërm, Katund i Vjetër dhe Shpal) për zgjerim të sipërfaqes së varrezave;
- Mungesën nga PPV, të llogaritjes së sipërfaqeve për përdorim toke si varreza për kapacitet e këtyre fshatrave;

V E N D O S I:

1. Miratimin e zgjerimit/shtimit të sipërfaqes së varrezave të fshatit Rreth i Epërm, njësia administrative Rubik, 4603, Zonë Kadastrale 3229, me një sipërfaqe shtesë prej **672 m²**, bashkia Mirditë
2. Miratimin e zgjerimit/shtimit të sipërfaqes së varrezave të fshatit Katund i Vjetër, njësia administrative Rubik, 4603, Zonë Kadastrale 2215, me një sipërfaqe shtesë prej **1 344 m²**, bashkia Mirditë

3. Miratimin e zgjerimit/shtimit të sipërfaqes së varrezave të fshatit Shpal, njësia administrative Orosh, 4605, Zonë Kadastrale 1221, me një sipërfaqe shtesë prej **796 m²**, bashkia Mirditë
4. Planvendosja me sipërfaqet përkatëse dhe zonat kadastrale, bashkëlidhur, *pjesë përbërse e këtij vendimi*
5. Zgjerimi i propozuar është në përputhje me planet e zhvillimit vendor dhe nevojat komunitare për varreza si dhe garanton respektimin e kushteve sanitare dhe distancave mbrojtëse sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik dhe legjislacionit në fuqi
6. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë; Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Drejtoria Juridike dhe APPM, për zbatimin dhe ndjekjen e procedurave të mëtejshme, si dhe rakordimi me ASHK për statusin juridik
7. Zbatimi i këtij vendimi, bëhet pasi të plotësohet procedura administrative me konfirmimet e statusit juridik të pronës sipas planrilevimit, nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!


SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAËU





**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2059 Prot.

Rrëshen më, 21 . 05 . 2025

P/VENDIM

Nr. 52 datë 27 . 05 . 2025

PËR

**“MIRATIMIN E ZGJERIMIT TE SIPERFAQES SE VARREZAVE, RRETH I EPERM,
SHPAL, KATUN I VJETER, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), neni 6, gërma “i”, të VKM.nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, (të ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen e pronave private për interes publik”, i ndryshuar,

Duke marrë në konsideratë:

- Kërkesën e banorëve të fshatrave përkatës (Rreth i Eperm ,Shpal,Katun i Vjetër) për zgjerim të sipërfaqes se varrezave;
- Mungesën nga PPV,të llogaritjes së sipërfaqeve për përdorim toke si varreza për kapacitet e këtyre fshatrave;

V E N D O S I:

1. Miratimin e të shtimit të sipërfaqes,fshati Rreth i Eperm.zonë kadastrale 3229,me një sipërfaqe shtesë prej 672 m2(pritet konfirmim nga ASHK) për statusin juridik te pronës.
2. Miratimin ne parim të shtimit të sipërfaqes,fshati Shpal.zonë kadastrale 1221,me një sipërfaqe shtesë prej 796 m2(pritet konfirmim nga ASHK) për statusin juridik te pronës.gjithashtu miratim nga autoritetet përkatëse për mundësinë e ndërhyrjes.

3. Miratimin ne parim të shtimit të sipërfaqes,fshati Shpal.zonë kadastrale 2125,me një sipërfaqe shtesë prej 1344 m2(pritet konfirmim nga ASHK) për statusin juridik te pronës.
4. Zgjerimi i propozuar është në përputhje me planet e zhvillimit vendor dhe nevojat komunitare për varreza,si dhe garanton respektimin e kushteve sanitare dhe distancave mbrojtëse sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik dhe legjislacionit në fuqi
5. Ngarkohen APPM, Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria Juridike për zbatimin dhe ndjekjen e procedurave të mëtejshme,si dhe rakordimi me ASHK për statusin juridik të pronave përkatëse.
6. Bashkëlidhur planvendosja ,me sipërfaqet përkatëse dhe zonat kadastrale.
7. Zbatimi i këtij vendimi bëhet pasi të plotësohet procedura administrative me konfirmimet e statusit juridik të pronës sipas planrilevimit, nga ASHK.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"(të ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETARI

Gasper TOPOLLAJ

KRYETARI

Aleksandër PICA KU

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit :

Drejtoria BUAP

Drejtoria Juridik/Prokurimeve:

Paraqiti Projektin:

Juljan TUSHA

Kastriot BICA

Manjola DODA

K R Y E T A R I

Albert MËLYSHI

ME DELEGIM KOMPETENCASH

N/KRYETAR

Gjergj PRENGA

